

Takimi Koordinues i donatorëve Antitrafikim – 24/09/2019

Në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit, Nr 157 datë 22.10.2018 *“Për marrjen e masave për zbatimin e qasjes së gjerë sektoriale/ndërsektoriale, si dhe ngritjen dhe funksionimin e mekanizmit sektorial/ndërsektorial të integruar”*, sot u zhvillua takimi koordinues i donatorëve Antitrafikim.

Në takimin që u drejtua nga Zëvendësministre e Brendshme znj. Rovenà Voda, në cilësinë e Koordinatorit Kombëtar Antitrafikim morën pjesë përfaqësues të Delegacionit Europian, Këshillit të Evropës, UN, OSBE, IOM, GIZ, Ambasadës Amerikane, Angleze, Gjermane, Franceze, Holandeze, Suedeze, si dhe përfaqësues të Kryeministrit dhe Ministrit të Brendshme.

U diskutua mbi prioritetet e Qeverisë Shqiptare bazuar në *“Planin Kombëtar të Veprimit për Luftën Kundër Trafikimit të Personave 2018-2020”*, bashkëpunimi mes organizmave ndërkombëtar dhe strukturave shtetërore, të cilat kanë në fushën e përgjegjësisë së tyre luftën kundër trafikimit të personave.

Nga pjesëmarrësit u shpreh angazhimi për të vazhduar mbështetjen dhe bashkëpunimin në realizimin e prioriteteve dhe objektivave të Qeverisë Shqiptare në këtë fushë, nëpërmjet implementimit të projekteve e ndihmës financiare të tyre.